



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 60
Prishtinë, më 3.4.2019, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Driton Çausi, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Luljeta Veselaj-Gutaj dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Munguan: Arbërie Nagavci, Fidan Rekaliu, Abdyl Salihu dhe Verica Qeraniq.

Përfaqësues të tjerë: Shyqiri Bytyqi-Ministër i MASHT, Arbër Gecaj, zëvendësministër i MASHT-it, Vjollca Shala, nënkryetare e SBASHK-ut, Blerim Mahmuti, SBASHK, Besa Halili-Krasniqi, Këshilli i Prindërve të Prishtinës.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Diskutim lidhur me kompensimin e orëve të humbura nga greva e mësimdhënësve;**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

- 2. Diskutim lidhur me kompensimin e orëve të humbura nga greva e mësimdhënësve;**

Ismajl Kurteshi, tha se arsyeja e këtij takimit të përbashkët është gjetja e një zgjidhjeje për kompensimin e orëve të humbura. Qëndrimi i komisionit është i ditur për të gjithë, i cili është për kompensimin e orëve të humbura gjatë grevës. Në vazhdim, Kurteshi tha se Komisioni është i befasuar me qëndrimin e SBASHK-ut për moskompensimin e orëve. Komisioni konsideron që takimi duhet të mbahet pa praninë e mediave, në mënyrë që të bisedohet me lirshëm dhe të ketë hapësirë më të mirë për arritjen e marrëveshjes, ndërsa pas përfundimit të takimit do të dalim me deklaratë për media.

Shyqyri Bytyqi, ministër i MASHT-it, tha që vendimi për kompensimin e orëve ka ardhur nga konsultimet që kanë pasur me DKA-të, Këshillin e prindërve dhe ekspertë të arsimit, për të gjetur mënyrën më të mirë të kompensimit të orëve. Si ministri, kemi qenë të hapur edhe për SBASHK-un. I kemi ftuar në dy takime, ku kemi shprehur gatishmërinë për gjetjen e një zgjidhjeje dhe kemi kërkuar që nëse SBASHK-u ka ndonjë propozim më të mirë, ne jemi të gatshëm për modifikim të vendimit për formën e kompensimit të orëve. Në takimin e parë që kemi pasur me sindikatën, ne kemi parë një vullnet për të gjetur zgjidhjen e problemit, ndërsa në takimin e dytë, ku ishte si takim zyrtar, gjërat ndryshuan sepse ata erdhën me gjëra të reja, kushte të reja madje edhe kushte që nuk i përkasin fare Ministrisë së Arsimit, siç është kërkesa për koeficient. Jemi në një situatë ku nuk kemi edhe shumë hapësirë për të bërë më shumë. Jemi të gatshëm që të arrijmë një zgjidhje sa më të mirë, për shkak të nxënësve. Sot jemi në një situatë urgjente, e cila kërkon zgjidhje urgjente për kompensimin e orëve, andaj nëse SBASHK-u nuk dëshiron të jetë pjesë e kësaj zgjidhjeje, ministria duhet të kërkojë nga DKA-të që të plotësojnë orarin e orëve.

Vjollca Shala, tha se kemi qenë dhe jemi për bashkëpunim me të gjitha institucionet e Kosovës kur bëhet fjalë për nxënësit. Në mbledhjen e fundit të SBASHK-ut kemi propozuar që të tërhiqet vendimi i ministrit për kompensimin e orëve, mirëpo, nuk ndodhi një gjë e tillë, përveç kësaj nuk e ka parë të arsyeshme as të takohet me partneret e tij, me qëllim zgjidhjen e situatës së krijuar. Vendimin e ministrisë e kemi dërguar në gjykatë dhe jemi në pritje të vendimit të cilin do ta respektojmë cilido që të jetë ai. SBASHK-u ka dal më kërkesë të re lidhur me përmirësimin e koeficientit në Ligjin e Pagave për mësimdhënësit ciklit klasor I-V, andaj SBASHK-u pret realizimin e këtyre dy kërkesave, në mënyrë që të bëhet kompensimi i orëve të humbura.

Besa Halili-Krasniqi, tha që ky vit shkollor ka qenë një vit shumë i vështirë për prindërit, për nxënësit, për të gjitha institucionet përgjegjëse, por kuptohet edhe për SBASHK-un. Është për keqardhje që këto tema nuk diskutohen me kohë dhe nuk garantohet një shkollim cilësor për fëmijët tanë. Gjatë grevës, ne i kemi përkrahur mësimdhënësit për kërkesën që ata kanë pasur për rritjen e pagës, por nuk kemi menduar që do të bëhet problem çështja e kompensimit të orëve, duke menduar që ato do të kompensohen.

Besa Halili-Krasniqi kontestoi bazën ligjore në të cilën bazohet SBASHK-u për moskompensimin e orëve, duke ua rikujtuar se mësimdhënësit janë paguar për kohën sa ishin në grevë. Ajo tha se Këshilli i Prindërve ka pritur një dinamikë me të madhe të punës me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje, pas gjithë këtyre vonesave tash edhe kompensimit i ka humbur kuptimi. Do të mbingarkohen nxënësit me zëvendësimin e 15 ditëve për shkak se jemi në përfundim të viti shkollor. Ajo pyeti SBASHK-un se a duhet edukimi dhe shkollimi i fëmijëve të

bëhet peng i vendimeve të gjykatave, sepse me herët ka pasur gjykata që e kanë ndalua mësimin por ju keni rrezikuar jetën, në mënyrë që t'i edukoni fëmijët.

Blerim Mehmeti, tha që ne jemi të gatshëm të zëvendësojmë javën e fundit të mësimin në qoftë se, deputetët kanë vullnetin që të bëjnë ndryshim plotësimin e ligjit, për ndryshimin e koeficientit nga 1 në 5, dhe ta barazojnë me koeficientin 6 deri 9. Viti shkollor nuk cenohet nëse materia shtjellohet mbi 75% dhe atëherë ai vit konsiderohet valid.

Ismajl Kurteshi, tha se nga diskutimet e përfaqësuesit të SBASHK-ut u paraqitën dy kërkesa; njëra që kanë vendosur të presin vendimin e gjykatës dhe tjetra që nëse ndërmerren hapa nga deputetët për ndryshimin e Ligjit për paga do të kompensohet vetëm një javë mësim. Është brengosës fakti që SBASHK-u arsyen për mosmbajtjen e mësimin, herë e gjen tek ministria, herë tek deputetët, por në fund të gjithë kësaj po pësojnë fëmijët, me të cilët askush nuk ka të drejtë të bëjë lojëra.

Sa i përket kërkesës për ngritje të koeficientit për mësimdhënësit, si komision vlerësojmë se ndaj kësaj kategorie është bërë një diskriminim dhe jemi pajtuar që të shikojmë mundësitë e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për paga apo ndonjë formë tjetër.

Teuta Haxhiu, tha se gjithë atë çfarë kishte për të thënë e tha përfaqësuesja e prindërve. Kjo çfarë po bënte SBASHK—u, është për interesa personale, janë të zënë me trajnime dhe të ardhura të larta nga disa burime. SBASHK-u, kurrë nuk ka menduar për interesin e fëmijëve, për përmirësimin e kushteve të tyre, asnjëherë nuk ka menduar si të veprojnë për 420 mësimdhënës të sëmurë. SBASHK-u asnjëherë deri më tani nuk e ka përmendur çështjen e diskriminimit në koeficient të mësimdhënësve nga klasa e I-V-të, këtë nuk e ka ngrit as gjatë shqyrtimit të Projektligjit për pagat në komisionin përkatës. Këshilli iniciues i mësimdhënësve nga klasa e I-V-të në takim me Komisionin kanë shprehur gatishmërinë e tyre për kompensimin e orëve, pavarësisht diskriminimit në koeficient që iu është bërë. Ata kanë dorëzuar në Kuvend një petition, ndërsa SBASHK-u asnjëherë deri me tani nuk ka ngritë zërin për ta, ndërsa sot ju vini me kërkesë e cila nuk është e re për ne si deputetë.

Kërkesa tjetër që ju po bëni është që ministri ta tërheq vendimin, por kush është punëdhënësi në këtë rast? Ajo që e ka befasuar më së shumti ka qenë një deklaratë e kryetarit të SBASHK-ut, kur ka thanë se, më mirë të humbë një vit se shumë vite. Tjetra që thatë ju, është se nëse realizohet 75% e planprogramit atëherë është vit valid, kjo është tmerrshme e pastaj po flisni për deputetët. Në Gjakovë mbi 90% e mësimdhënësve dalin në shkolla, kështu që s'është e vërtetë kur ju thonin që mësimdhënësit nuk dalin në punë.

Luljeta Veselaj Gutaj, theksoi se qëllimi i gjithë këtij takimi është të gjendet një zgjidhje e përbashkët e jo të krijojmë më shumë probleme, sepse secili mbanë përgjegjësi për deklaratimet e tij. Është momenti i fundit që të gjendet një zgjidhje dhe për këtë arsye do të doja që pas këtij takimi të dalim të gjithë, bashkërisht me një qëndrim të unifikuar. Ne kemi pasur disa takime me ekspertë të fushës së arsimit, në mënyrë që t'a dimë se cila është zgjidhja. Parimisht ajo tha se e ka mbështetur vendimin e Ministrisë së Arsimit për kompensimin e orëve, qëndrim të cilin e ka ende, andaj lidhur me tejkalimin e kësaj gjendjeje, propozoi që për kompensimin e 15 ditëve të humbura, java e parë mund të kompensohet duke hequr dorë nga disa ditë të festave, si Dita e Kushtetutës, që është më 9 prill, 22 dhe 28 prill, janë Pashkët katolike dhe ato ortodokse, 1 dhe 9 maj.

Java e dytë, pajtohem me SBASHK-un që të zgjatet një javë mësimi në fund të vitit dhe java e tretë të bëhet sipas planeve individuale, sipas specifikave të shkollave, ku mjafton një orë më shumë të mbahet në ditë, e gjitha kjo të arrihet në harmonizim me prindërit. Ajo që e kërkuat në lidhje me koeficientin e mësimdhënësve të nivelit nga 1 deri në 5, ka qenë diçka shqetësuese për të gjithë. Jemi që të rritet koeficienti i këtyre mësimdhënësve, por ne nuk mund të bëjmë asgjë pa hyrë në fuqi ligji. Sot është mirë të dalim me një zgjidhje prej këtij takimi, për hir të fëmijëve.

Albulena Balaj-Halimaj, tha se duhet lënë inatin anash dhe të nisim punën, për të gjetur një zgjidhje. Ajo citoi fjalët e përfaqësueses së Këshillit të prindërve, që u tha më herët “ ka pasur vendime të gjykatave që ua kanë ndaluar mësimin, por ju keni vazhduar të punoni”, ky është mesazh i madh, që na e dhanë prindërit. Nuk duhet t’ju shqetësojë shumë deklaratat e një deputeti. Do të ishte shqetësuese nëse ajo deklaratë do të ishte e një subjekti politik apo e disa subjekteve politike. Nëse ministri është i hapur për marrëveshje të re dhe sindikata kërkon të tërhiqet vendimi, atëherë, normalisht që vendimi tërhiqet që me vonë të merret vendim tjetër. Si Komision jemi takuar me mësimdhënësit të nivelit nga 1 deri në 5 dhe iu kemi premtuar që do merremi me çështjen e ngritjes së koeficientit për ta, pavarësisht se SBASHK-u nuk është dashur të pranojë një marrëveshje të tillë diskriminuese. Personalisht do ta mbështes nismën për fillimin e procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për paga, pavarësisht se ndoshta nuk është momenti i duhur. Kërkoj që të dalim me një qëndrim të përbashkët nga ky takim dhe e mbështes propozimin e deputetes Veselaj-Gutaj për kompensimin e orëve të humbura.

Mufera Shinik, tha se SBASHK-u po deklaroi se është për t’i ndihmuar arsimit, por si mund të ndihmohet arsimit kur nxënësit për tre javë kanë humbur 100 orë, ndoshta edhe më shumë dhe kompensimi i këtyre orëve kushtëzohet me ngritje të koeficientit që për të është një turp. Në kohën e grevës SBASHK-ut, ka pasur përkrahje nga deputetët, ministri dhe nga Këshilli i prindërve, ndërsa sot iu bëjë thirrje që të mos pengoni, sepse shkollat nuk janë fabrika, nuk prodhojnë këpuca e as këmisha dhe këto 100 orë duhet kompensuar, andaj kërkoj nga ministri të bëhet ajo që duhet, që të kompensohen orët.

Driton Çausi, tha se ky takim i komisionit është organizuar me qëllim për të gjetur një zgjidhje, nëse dalim nga ajo që përfaqësojmë dhe flasim si qytetarë të thjeshtë të kësaj Republike, jemi të vetëdijshëm për cilësinë e dobët të arsimit, për arsye të gjithë atyre që kanë ndodhë para, gjatë dhe pas luftës. Nga disa hulumtime të reja, thuhet se në Kosovë mbahen 70 orë mësim më pak se sa në vendet e BE-së, rezultatet e testit PISA kanë treguar për nivelin e cilësisë në arsim, pastaj raporte tjera që thonë se nxënësit kosovarë janë 7 vite prapa moshatarëve të tyre. Gabimi është bërë kur SBASHK-u ka pranuar dhe nënshkruar një marrëveshje të tillë, ku Komisioni nuk ka qenë fare i përfshirë. Një formë e kompensimit të orëve mund të jetë edhe zgjatja e ditëve të mësimi, nëse një gjë e tillë është e mundur. Këtu po shoh që po mungon vullneti prej anës së SBASHK-ut dhe në deklaratat që i kanë dhënë gjatë grevës, nuk janë deklaruar se nuk do të kompensohen orët e humbura. Kur thuhet që po presim vendimin e gjykatës, nuk vjen në shprehje kompensimi i orëve sepse ne e dimë se si zgjasin këto procese gjyqësore.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, tha që kemi ardhur në një pozitë të vështirë, andaj për këtë situatë dikush është përgjegjës dhe duhet të jap llogari. SBASHK-u nuk është dashur të bëjnë

marrëveshje me Kryeministrin dhe Kryetarin e Kuvendit sepse kjo është punë e Ministrisë së Arsimit. Orët e humbura asnjëherë nuk mund të kompensohen në mënyrën më të mirë të mundshme, këtë e kanë treguar edhe përvojat e mëhershme. Fillimisht, nuk është dashur të vijmë deri këtu, realisht kur i kemi rritur pagat për vete, për ministri pse jo edhe për mësimdhënësit. Kërkesa për rritjen e koeficientit, nga mësimdhënësit ka qenë shumë legjitime. Dallimi i koeficientit mes nivelit 1 deri në 5 dhe 6 deri në 9, nuk është faji ynë, por vetëm i SBASHK-ut. Edhe unë si kolegët që thanë më herët, jam për ta rregulluar këtë koeficient, por në këtë moment është problem. Meqë sindikata ka kërkuar që ministri ta tërheq vendimin e tij, atëherë ministri le ta tërheq dhe sindikata të vazhdojë punën, ndërkohë pajtohem me propozimin e Luljetës dhe për koeficient do të bashkëpunojmë të gjithë.

Ismajl Kurteshi, në fund të takimit konstatoi që Komisioni ka kërkuar nga SBASHK-u që të kompensohen orët, Këshilli i prindërve ka dalë me të njëjtën kërkesë, po ashtu, edhe ministria ka të njëjtin qëndrim, do të thotë të tri palët janë të një mendimi. Konstatimi i dytë është që kërkesat e SBASHK-ut janë plotësuar. Kërkesa e parë është tërheqja e vendimit dhe ministri sot u deklarua që është i hapur ta tërheq vendimin e tij, dhe ky ka qenë kushti që SBASHK-u të bëjë kompensimin e orëve. Kërkesa e dytë është që të fillojmë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për paga dhe ne si Komision kemi marrë vendim që të iniciojmë plotësim ndryshimin e ligjit, me amendamentin për barazinë e mësuesve për klasat e para deri tek klasat e pesta. Këto kërkesa i keni pasur dhe këto kërkesa i keni të plotësuar. Propozimi deputetes Luljetë, është një propozim shumë i mirë, të cilin duhet t'a keni parasysh. Në fund kërkoj nga SBASHK-u që ta thërrasë Këshillin Drejtues dhe t'ua prezantoni situatën dhe kërkesat tuaja të plotësuar edhe kërkesat tona edhe planet, në mënyrë që mësimi të kompensohet. Jam i gatshëm në emër të komisionit, të deklarojë para mediave, që ne do e iniciojmë plotësim ndryshimin e Ligjit për paga, që Ministria e Arsimit është për një marrëveshje tjetër dhe SBASHK-u do të thërrasë mbledhjen e këshillit ku do t'i shqyrtoni kërkesat, por edhe që keni marrë premtim për këto dy kërkesa që do realizohen. Kjo është zgjidhja më e racionale për të dalë nga ky takim, çfarëdo që bëjmë ndryshe tregohemi të papërgjegjshëm ndaj prindërve.

Shyqyri Bytyqi, ministër, tha se ministria nuk punon dhe nuk nxjerr vendime me inate. Vendimet që nxjerr ministria janë në kuadër të përgjegjësisë që ka në bazë të legjislacionit në fuqi. Vendimi i parë që kemi marrë ka qenë në bashkëpunim me DKA-të, nëse e tërhiqet vendimi prapë duhet të marrim vendim të ri për formën që merremi vesh për kompensim të orëve. Ne e kemi thënë edhe më herët, që çfarëdo forme që është e mirë për kompensimin e orëve, e përkrahim, kështu që pajtohem me propozimin tuaj por vetëm të jemi të qartë që ne obligohemi të marrim vendim.

Vjollca Shala, tha se është mirë që ministri është i gatshëm ta tërheq vendimin, por kjo ka qenë kërkesë në mbledhjen e kaluar. SBASHK-u ka kërkesë për rritjen e koeficientit për nivelin nga 1 deri në 5, në mënyrë që të jetë i barabartë me atë të 6 deri në 9. U tha që sindikata po iu bënë presion mësimdhënësve, gjë që s'është e vërtetë sepse në asnjë moment SBASHK-u nuk u bënë presion mësimdhënësve. Sa i përket nismës për ndryshim plotësimin ligjin për koeficientin, ne duhet ta shohim se ka ndryshuar koeficienti dhe jo vetëm të nisë iniciativa dhe nëse realizohen këto kërkesa, SBASHK-u është i gatshëm të bëjë kompensimin e një jave të mësimin në fund të vitit shkollor.

Arbër Gecaj, tha se nga diskutimet po shihet se SBASHK-u nuk ka vullnet për gjetjen e një zgjidhjeje, andaj duhet të shohim për një zgjidhje tjetër në mes mësimdhënësve dhe DKA-ve duke i përfshirë këto kërkesat e sindikatës.

Ismajl Kurteshi, në përmbyllje të takimit tha se Komisioni nuk e përjashton asnjë palë. Kemi arritur në një konkluzion, ku dy kërkesat e SBASHK-ut janë plotësuar, një plan i punës është propozuar, andaj këto kërkesa tona t'i dërgoni në Këshillin drejtues dhe Komisioni do t'i fillojë procedurat në momentin që na e lejon ligji.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Ismajl Kurteshi